

Akt Thmелиmi i shoqërisë tregtare“ B&T Energy” sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë ,në Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; me vullnetin tonë të lirë , të shprehure dhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortakët :Shefjet Billa i biri i Arifit dhe i Sihes i datëlindjes 11. 01. 1952 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë në Rrugën "Teodor Keko" banesë private,Urim Tafhasi i biri i Shabanit dhe i Farijes i datëlindjes 01. 01. 1973 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë në Rrugën "Jordan Misja " banesë private dhe Zyber Halili i biri i Xhaferit dhe i Ahmedies, lindur në Skavic dhe banues në Tiranë në adresën Rruga dhimitër Frenku banesë private, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësitëkufizuar “B&T Energy” sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare e quajtur “B&T Energy” sh.p.k. Shoqeria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar, ndërsa degët që mund të krijojen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtorjë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqërisë

Neni 2


(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:

Rruga Dy Drinat, Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.1, Apartamenit Nr. 4 Kukës.

Objekti i Veprimitarise

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :



Projektimi, implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaik, eolike, hidrike) të prodhimit të energjissë, të cilat shfrytezojnë burimet erinovueshme si dielli, era, uji, si dhe i veprave, infrastukturës ndihmëse të tyre.

Prodhimin dhe shitjen me shumicë apo pakicë të energjise elektrike, tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret, e energjise elektrike, (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike, apo ne bursa te tjera jashtë vendit.;

Ofrimi i konsulencave, per te tretet, ne lidhje me projektimin, ndertimin, implementimin dhe menaxhimin e impianteve per prodhimin e energjise se me burime te rinovueshme.

Kryerja e aplikimeve, per pajisjen e lejeve, licenceve, autorizimeve paraprake/ perfundimtare, me qellim zhvillimin e ketyre aktiviteteve, per vete apo pale te treta. Kryerjen e stidimeve te fizibilitetit, si dhe importim, shit/blerje te pajisjeve per ndertimin e impianteve te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme.

Zbatimin e projekteve, deri en venien ne funksionim te impianteve.

Pjesëmarrje në investimet industriale dhe tregtare, si dhe në aktivitete të ndryshme financiare, tregtare e industriale;

Blerja, shitja, marrja/dhënia me qira e pasurive të paluajtshme Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme, shqiptare apo të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie.

Në përgjithësi te gjitha aktivitetet industriale, tregtare, financiare, civile, te luajtshme ose te paluajtshme, që mund te lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë ose me objekt te ngjashëm ose te përafërt. Çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shgjiptar.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Shefqet Billa: Zoterues i 51 (pesëdhjetëenjë) kuotave me vlerë 1000 lekë secila të përgjithshme 51 000 Lekë që përben 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues Urim Tafhasi : Zoterues i 47.3 kuotave me vlerë 1000 lekë sejcila me vlerë të përgjithshme 47300 lekë që përben 47.3% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

3. Ortaku Themelues Zyber Halili: Zoterues i 1. 7 kuotave me vlerë 1000 lekë sejcila me vlerë të përgjithshme 1700 lekë.

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6


(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohe si Administrator i parë të shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Urim Tafhasi i biri i Shabanit dhe i Farjes i datëlindjes 01. 01. 1973 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë në Rugën "Jordan Misja " banesë private

Neni 7



Të ardhurat neto të shoqerisë ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me kuotat e kapitalit themeltar që disponojnë sejcili prej tyre.

Neni 8

Ortakët së bashku dhe kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Kanë të drejtë të caktojnë financiere ,likuidator për problemet e shoqërise .

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve, në të kundërt në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin "B&T Energy shpk" rrëth saj .

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanërisht Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti ithemelimit u përpiluanë 4 kopje , për t'jushpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "B&T Energy" sh.p.k

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

Ortakët themelues të shoqërisë "B&T Energy" shpk


Shefqet Billa

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Shefqet Billa".

Urim Tafhasi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Urim Tafhasi".

Zyber Halili

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Zyber Halili".